REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

**KRYETARI I KOMUNËS**
**MUNICIPAL PRESIDENT**
**PREDSEDNIK OPSTINE**

**Tel / Fax: 038/200-46002**
**Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.**
**E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net**

| | |
|---|---|
| **DATA/DATUM/DATE** | 18.09.2024 |
| **NR/BR.** | 300/24 |
| **PËR/ZA/TO** | **Kuvendin e Komunës së Ferizajt** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH** | **Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **NGA/OD/FROM** | **Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt** |
| **LËNDA/PREDMET/SUBJECT** | **Propozim – Vendim për anulimin e vendimit me nr. 01. Nr.69 të datës 31.07.2024 dhe Anulimin e pjesërishëm të vendimit me nr. 01 Nr. 09 të datës 03.02.2017** |

Në bazë te nenit 58 pika h te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të merr:

**VENDIM**

1. ANULOHET vendimi me nr. 01. Nr. 69 të datës 31.07.2024, përmes të cilëve përmes së cilit i është bartë aseti (Fabrika e Ujit) në Talinovc të Muhaxherëve, kompanisë rajonale të ujësjellësit K.R.U Bifurkacioni.

2. Anulohet Pjesërisht Vendimi me nr. 01 Nr. 09 i datës 03.02.2017 përmes së cilit është destinuar në tërësi parcela kadastrale 992-0 Z.K. Talinovc i Muhaxherëve me sipërfaqe 20380 $m^2$ për ndërtimin e fabrikës së ujit.

3. Vendimi me nr. 01 Nr. 09 i datës 03.02.2017 anulohet për pjesën e parcelës e cila nuk është përfshirw në projektin e fabrikës së ujit dhe atë për sipërfaqen 12454 $m^2$.

4. Obligohet Drejotria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ti bëjë ndarjen e parcelës dhe regjistrimin e tyre në operatin kadastral sipas këtij vendimi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt.

**A r s y e t i m**

Kuvendi i Komunës së Ferizajt me vendim numër 01. Nr. 69 të datës 31.07.2024 i ka bartur asetin (Fabrikën e Ujit) në Talinovc të Muhaxherëve, kompanisë rajonale të ujësjellësit K.R.U Bifurkacioni.

Ministria e Adminstrimit të Pushtetit Lokal me shkresën me nr. 020-514/7 të datës 02.09.2024 ka konstatuar se vendimi nuk është në harmoni me ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës me nr. 06/L-092 si dhe me ligjin për pronën publike me nr. 08/L-125 dhe njëkohësisht ka kërkuar nga komuna që të rishqyrtoj aktin dhe harmonizoj me legjislacionin në fuqi.

Vendimi me nr. 01 Nr. 09 i datës 03.02.2017 anulohet vetëm për sa i përket sipërfaqes e cila nuk është e përfshirë në projekt dhe ndodhet jasht rrethojave të fabrikës sepse Komuna e Feirzajt këtë pjesë të parcelës ne të ardhmen mund ta shfrytëzoj për qëllime tjera.

Komuna e Ferizajt ka hartuar propozim të veçant bazuar në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës me nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim të fabrikës së Ujit në Talinovc të Muhaxherëve kompanisë rajonale të ujësjellësit K.R.U Bifurkacioni andaj i propozoj Komitetit për Politik dhe Financa si dhe Kuvendit të Komunës që ta aprovoj në tërësi propozim vendimin ashtu siç edhe është përshkruar në dispozitiv.

*Të bashkangjitur gjeni;*

- *Vendimin e Kuvendit të Komunës me nr. 01. Nr.69 të datës 31.07.2024,*
- *Kërkesën për rishqyrtim me nr.* 020-514/7 të datës 02.09.2024,
- *Vendimi me nr. 01 Nr. 09 i datës 03.02.2017*

03.02.2017 09 Ferizaj Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

| KUVENDI I KOMUNËS<br>SKUPSTINA OPŠTINE<br>MUNICIPAL ASSEMBLY | 01.Nr. 09<br>Data: 03.02.2017 |
|---|---|

Në bazë të nenit 58 pika h dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 si dhe, nenit 51 paragrafi 2.9 dhe nenit 25 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01. Nr.28.06.2013, Kuvendi I Komunës në mbledhjen e mbajtur më **31.01.2017** mori këtë:

# V E N D I M

## PËR DESTINIMIN E PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE NR.992-0 ZK TALINOVC I MUHAXHERVE ME SIPËRFAQE PREJ 20380 m², PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT

**I**

Kuvendi i Komunës së Ferizajt e destinon ngastrën kadastrale nr.992-0 ZK Talinovc i Muhaxherve, me sipërfaqe prej 20380 m², pronë e Komunës e cila do të shërbej për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e ujit të pijshëm

**II**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në ministrinë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i KK-së

Faruk Guri

Ferizaj - Uroševac

06.08.2024

01 | 69 | 1

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 69
Data: 31.07. 2024

HYRESE - ULAZNA - INCOMING

06.08.2024

020-514

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt i datës 28.06.2013 me Nr. 01.Nr.50 si dhe nenit 6 pika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**

**PËR BARTJEN E ASETIT (FABRIKËS SË UJIT) NË TALINOVC TË MUHAXHERËVE, KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT "BIFURKACIONI"**

**I**

Aseti (objekti i fabrikës së ujit) i cili gjindet në ngastrën kadastrale 00992-0 Z.K.Talinoc i Muhaxherëve pronë e Komunës së Ferizajt me sipërfaqe prej 1630 m² i ipet në shfrytëzim K.R.U. "Bifurkacioni" në afat kohorë prej 99 vjeve për prodhimin e ujit të pijshëm.

**II**

Obligohet Drejtoria për Pronë dhe Kadastër që të bëjë matjen e pikave gjeodezike dhe të njejtin ta regjistrojë në libra kadastral.

**III**

Për këtë Vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës së Ferizajt si dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-514/7
Data Datum Date 02.09.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajit<br>Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | Erblin Hetemi , U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë 13/08/2024 Nr. 020-514 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit<br>Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë se aktit të Komunës së Ferizajit | |
| Lloji i aktit: | Vendimit | |

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| **Vendim Nr. 69 për bartjen e astetit në Talinoc të Muhaxherëve kompnaisë rajonale të ujësjellësit "Bifurkacioni"** |
| **I miratuar më datë: 31.07.2024** |
| **I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.08.2024** |

Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit vlerëson se **<u>akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi</u>**.

**Arsyetim**

Kuvendi i Komunës të Ferizajit me datën 31.07.2024 ka miratuar vendimin Nr. 69 për bartjen e astetit në Talinoc të Muhaxherëve kompnaisë rajonale të ujësjellësit "Bifurkacioni". Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal me të pranaur aktin e mirtuar nga Kuvendi i Komunës të Ferizajit ka ndërmarr veprime bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale për shqyrtim të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 81 *"shqyrtimin e detyrushëm të ligjshmërisë"* konstaton se:

Premabula, titulli dhe neni një (1) i vendimit Nr. 69 përcaktojnë tri çështje dhe si të tilla janë në kundërshtim me LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS. Në rastin konkret *"dhënia e pronës se paluajtshme për me pak se një (1) vit"* bazën ligjore në të cilën referohet vendimi, *"bartja e astetit"* emërtim i aktit dhënie në shfrytëzim e pronës në afat kohorë prej *"nëntëdhjetë e nëntë (99) vite"* nuk mund të trajtohen në një vendim për faktin se janë proceduar dhe forma të ndryshme lidhur me pronën e palujatshme komunale.

Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme me pak se një (1) vit por procedurat, format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale ashtu si njihet kjo e drejt me LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS nenin 6 paragrafi 1.

Komunat mund të bëjnë bartjen e pronës publike dhe formave tjera duke u bazuar në LIGJIN NR. 08/L-125 PËR PRONËN PUBLIKE neni 14 *"bartja e paluajtshmërive në pronësi publike për realizimin e interesit publik, transferimi i së drejtës pronësore përmes këmbimit, dhënia me qira, dhënia me koncesion dhe partneriteti publiko-privat, eksploatimi i resurseve natyrore dhe minerale në bazë të licencës, investimi monetar në letra me vlerë, patundshmëri dhe format e tjera të investimit kapital me qëllim përfitimi dhe donacioni dhe subvencioni i sendeve të luajtshme/i mjeteve monetare"*.

Ndërsa dhënian e pronës se paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë nga komunat deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite përmes shprehjes se interesit është e përcaktuar në LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS përkatësisht nenin 3 paragrafi 1.12 ku *"nënkupton procesin e konkurrencës së hapur ku fituesi zgjidhet në bazë të kritereve të specifikuara në thirrjen për ofertë"*.

Ministria e Admsinitimt të Pushtetit Lokal bazuar në të lartcekurat kërkon nga Kuvendi i Komunës të Ferizajitit qe të ndërmarrin veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtojë aktin dhe të harmonizojë më legjislacionin në fuqi.

Komuna. FERIZAJ

Zona Kadastrale .Talinoc i Muhaxherve

Drejt.për pro.gjeo.kad..

-Sektori i Pronës

# SKICA E MATJES Pa Përpjes




Ngjyra e verdhë tregon pjesen e ng.kad.992-0 me sip.12454m² zk.Talinoc i Muhaxherve pron e Komunës së Ferizajt

Vendim për anulimin e vendimit 01.nr.69të dates 31.07.2024 dhe anulimin e pjesrishëm 01.nr.09 data 3.02.2017.

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

Zhitore

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217060-00992-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **81715/2024** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.09.2024 - 08:31 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Talinoc I Muhaxherëve / Muhadžer Talinovac / Talinofci I Muhaxherëve |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-72217060-00992-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **20380** | | | |

## B. ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| "UTRINË" | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO · KOMUNA FERIZAJ · OPŠTINA UROŠEVAC · FERIZAJ UROŠEVAC

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land | **20380** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **PASURI E KOMUNËS SË FERIZAJT-DESTINUAR PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS SË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM** | 17022008 | TALINOC I MUHAXHERËVE / MUHADŽER TALINOVAC / TALINOFCI I MUHAXHERËVE / | | | **1/1** | 1/2017 | 21.02.2017 |